

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

12.02.2024

Ora, 12:18

**RENDI I DITËS**

1. Shqyrtimi i kërkesës ankimore me nr. 01, datë 04.01.2024, me ankues subjekti

Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, me objekt:

- Kundërshtimin e vendimet nr. 823, datë 07.12.2023 të KSHZ;

- Shfuqizimin e pikës 96, të vendimit nr. 823, datë 07.12.2023 të KSHZ.

2. Shqyrtimi i Kërkesës Ankimore nr. 03, datë 08.01.2024, depozituar nga Partia

G99, kryetari z. Redi Shtino, me objekt: Kundërshtim i vendimit nr. 823, datë

7.12.2023 të KSHZ.

3. Shqyrtimi i Kërkesës Ankimore nr. 04, datë 29.12.2023, depozituar nga Partia

Aleanca Popullore, me objekt:

- Kundërshtim i vendimit nr. 823, datë 7.12.2023 të KSHZ;

- Shfuqizimin e pikës 101, të vendimit nr. 823, datë 7.12.2023 të KSHZ.”.

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z.Y.Merkaj, znj.J. Josifi, z.K.Puleri, z.E. Mema.
- **Parti Politike:** PPKDSH (znj. O. Shkambi, z. P. Shkambi)
- **Të tjerë:** S'ka

**Z. K. Bele:** Përshëndetje, çelim seancën për shqyrtimin në themel të kërkesës ankimore nr. 1, me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 823, datë 7.12.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021”, me ankues

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë. Relatojmë se në këtë fazë të procedimit, kjo kërkesë ankimore është bashkuar me kërkesën ankimore nr. 3 me të njejtin objekt, me ankues subjektin Partia G99, si dhe me kërkesën ankimore nr. 4 me të njejtin objekt, me ankues Partia Aleanca Popullore. Prezent është KAS me pjesëmarrje të plotë, si dhe administrata e KQZ-së dhe pala ankuese, përfaqësuesit e Partisë Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, përfaqësuar nga nënkryetaria zonja Orjeta Shkambi. Gjithashtu relatojmë se KAS në seancat e mëparshme ku ka vendosur kalimin në seancë të këtyre ankimimeve, ka marrë kohën e nevojshme duke lënë një afat përtej afatit 45 ditë, për të vlerësuar ardhjen e ankimimeve nga subjekte të tjera, të cilat janë pjesë e vendimit të Komisionerit nr. 823, datë 7.12.2023. Deri tani nga ana e sekretarisë na është bërë me dije se nuk kemi ankime të tjera. Në këto rrethana do të vazhdojmë seancën duke konsideruar materialet dhe ankimet që kemi pjesë të këtij shqyrtimi administrativ në themel. I japim fjalën fillimisht ankueses e cila ka paraqitur një kërkesë me shkrim. Gjithashtu ka shpjeguar dhe në seancën paraprake. Ju lutem shkurtimisht nëse keni diçka për të thënë, apo mund të konfirmoni këto që keni shkruar!? Nëse keni diçka tjetër, ndonjë dokument, a ndonjë provë për të paraqitur, jeni të mirëpritur. Fjala është për ju zonja Shkambi!

**Znj. Orjeta Shkambi, nënkryetare e PPKDSH:** Mirëdita të gjithëve! Unë kam autorizuar juristin, zotin Pal Shkambi për ta trajtuar këtë çështje.

**Z. K. Bele:** Në rregull! Zoti Shkambi, ju lutem në mënyrë sa më të përmbledhur, atë çfarë raporti i audituesve ka konstatuar, ju lutem prapësimet tuaja!

**Z. Pal Shkambi jurist, përfaqësues i zonjës Orjeta Shkambi:** Mirëdita, faleminderit! Sigurisht, herën e shkuar keni lënë detyrë me paraqit dokumentacionin me legjitimuar

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

përfaqësimin e Partisë Popullore, kam sjellë dokumentacionin këtu për të bindur komisionin e nderuar, se përfaqësuesit e këtij subjekti janë legjitimë. Kam sjellë statusin e Partisë Popullore Kristiandemokrate, autorizimin, dokumentacionin e nënkryetares që ka cilësinë e kryetares së komanduar nga asambleja e Partisë Popullore Kristiandemokrate dhe gjithë dokumentacionin po jua dorëzoj tani në këtë moment. (dorëzon dokumentacionin).

**Z. K. Bele:** Ne e konsideruam legjitimitimin të plotë, pavarësisht se këto dokumenta plotësojnë dosjen. Ju lutem lidhur me objektin, pse i prapësoni gjetjet, ku konsiston? Në mënyrë të përmbledhur, pasi e keni dhe të shkruar.

**Z. Pal Shkambi jurist, përfaqësues i zonjës Orjeta Shkambi:** Mund ta them dhe me fjalë shkurt, mund edhe ta lexoj. Ju e keni përpara kërkesën! Kërkesë ankimore kundër vendimit nr. 823, datë 7.12.2023...


**Z. K. Bele:** Të lutem, nuk ka nevojë të lexohet kërkesa!

**Z. Pal Shkambi jurist, përfaqësues i zonjës Orjeta Shkambi:** Në rregull, edhe baza ligjore s'ka nevojë sigurisht...

**Z. K. Bele:** Nëse keni diçka që doni të shtoni, ne kërkesën e kemi parë. Përndryshe mund t'i qëndroni kësaj dhe ne vazhdojmë.

**Z. Pal Shkambi jurist, përfaqësues i zonjës Orjeta Shkambi:** I qëndrojmë kësaj dhe kam për të thënë këtë gjë shkurt. Në rradhë të parë i qëndrojmë kërkesës. Së dyti, dua të them që këtë forcë politike, këtë parti politike e kam ngritur unë në vitin 2011, sikurse

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

e thashë dhe herën e shkuar. E kam ngritur si domosdoshmëri për t'u përpjekur e për t'i dalë zot popullit shqiptar, jo unë por shqiptarët, me një frymë vëllazërimi dhe bashkimi. Është miratuar në gjykatë dhe janë dashur 18 muaj për t'u miratuar në gjykatë. Kam bërë çdo gjë të mundur për të bashkuar intelektualët dhe klasën e mesme për t'i dalë zot këtij vendi, pa dashur të bëj politikë. Në vitin 2017, është kërkuar nga politika shqiptare, nga Kuvendi i Shqipërisë, nga ndërkombëtarët, nga Avokati i Popullit që juristët shqiptarë mundësisht për të dhënë kontribut për reformën në drejtësi. Një ndër ata jam dhe unë, kishin aplikuar vetëm 13 juristë dhe i 14 isha unë dhe u bënë 192 sapo aplikova unë...

**Z. K. Bele:** Të lutem të përqëndrohemi te çështja!

**Z. Pal Shkambi jurist, përfaqësues i zonjës Orjeta Shkambi:** Kam dhënë dorëheqjen brenda afatit ligjor sipas kërkesave ligjore dhe kushtetuese dhe është zgjedh një kryetar i cili quhet Pjerin Kodraçaj. Pjerin Kodraçaj ka dhënë dorëheqje për arsye të tij, me vullnet të lirë, përpara kryesisë, përpara nënkryetarëve dhe sekretarit të përgjithshëm. Është bërë kërkesa në gjykatë se ai ka dhënë dorëheqje përfundimisht nga të gjitha pozicionet si kryetar dhe nga të gjitha pozicionet e partisë. Sipas statutit të partisë, neni 45, pika 1 shpreh qartë se “në rastet kur kryetari jep dorëheqje, mblidhet asambleja kombëtare nga sekretari i përgjithshëm dhe vendos për njërin nga nënkryetarët”. Duke qenë se zonja Orjeta ishte dhe kandidatë për deputete, kur erdhi shkresa nga KQZ-ja për të marrë pjesë në Kuvendin e Shqipërisë, numri 16 zëvendësoi numrin 6, Lorenc Perlat Lukën, pavarësisht se nuk mori pjesë. Asambleja Kombëtare e ka zgjedhur kryetare të komanduar deri në momentin e mbledhjes së kongresit të partisë dhe që të zgjidhet kryetari nga ky kongres. Kongresi nuk është mbledhur deri në këtë moment dhe Orjeta Shkambi është kryetare. Përfundimisht me të marrë dijeni Orjeta në lidhje me auditimin

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 12.02.2024*

për kontrollin e partisë për pasqyrat financiare, për hyrjet dhe daljet, prurjet dhe shpenzimet. Sapo erdhi shkresa, Orjeta në cilësinë e nënkryetares së partisë, deklaroi se me datë 30.05.2022 ka marrë njoftim në rrugë postare nga zoti Elton Tirana, ekspert kontabël, i caktuar me detyrë nga KQZ-ja për të bërë auditimin e detyrueshëm të partive politike të fondeve të përfituara dhe shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2021. Orjeta e ka telefonuar me numrin e telefonit të saj që është përcaktuar aty, 069 93 25 722 dhe ka biseduar në lidhje me realizimin e auditimit të partisë. Pra, i ka bërë me dije se është e gatshme që të realizojmë auditimin e partisë. Më pas ka telefonuar zoti Elton dhe sigurisht ka kërkuar ndihmë për të ardhur te selia e partisë. Zonja Orjeta e ka ndihmuar duke e orjentuar që të shkonte te selia. E ka pritur, kam qenë prezent edhe unë, sepse unë jam i shoqi i Orjetës, për dijeni. E kemi pritur dhe respektuar. I kemi vënë në dispozicion pasqyrën financiare të vitit 2021 dhe ka bërë pyetjet e tij, a keni pas të ardhura dhe përfitime, nëpërmjet rrugëve ligjore, apo jashtë atyre ligjore? E vumë në dijeni që nuk kemi pas asnjë lloj të ardhure, as nga kuotizacioni i antarëve, sepse partia ka mbetur e ngrirë. Kryetari ka dhënë dorëheqjen, nënkryetari ka mbetur në gjendje pezull siç ka mbetur e gjithë politika shqiptare, pothuajse. E vumë në dijeni zotin auditues që nuk kemi pas, jo vetëm për vitin 2021, por që në fillimet e saj nuk ka pas asnjë çerek leku, as letër, as fletore, as laps, asgjë. Kjo parti nuk ka marrë asgjë prej askujt në këtë jetë. Si mundet të kontrollohet një parti politike, si mundet me u gjobit, se të kontrollohet është normale. Si mund të gjobitet një parti politike kur kurrë në pasqyra financiare shtetërore, private, publike, në asnjë lloj forme, as edhe një lek kurrë se ka marrë? Çfarë ka për të kontrolluar ajo parti politike? Ndërkohë që futen me miliona lekë në mënyrë të padrejtë...

**Z. K. Bele:** Në rregull, ju kuptova!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

**Z. Pal Shkambi jurist, përfaqësues i zonjës Orjeta Shkambi:** Të lutem se mbarova, i nderuar drejtues i seancës, kryetar! Në këto rrethana i kemi sqaruar të gjitha! Për çdo gjë që ka pyetur Orjetën, por prezent isha dhe unë, që e kisha ngritur vetë partinë, çfarë i kemi thënë me gojë i kemi dhënë dhe deklaratën zotit Elton. Ai kishte ardhur me njerëz në Shkodër dhe tha se ishte për shpejt me lëviz se kishte ardhur për të bërë një rrugë e për të mbaruar dy punë. I kemi dhënë deklaratën, pasqyrën financiare, e kemi respektuar. Jemi gjobitur kot fare. Jemi gjobitur dhe 10 herë të tjera po për të njejtën arsye. Çdo gjë është ndërtuar fallso sikurse çdo gjë në këtë vend. E them me keqardhje këtë gjë, çdo gjë është mashtrim, mashtrim...

**Z. K. Bele:** Të lutem mund të ndalosh se duhet të flas dhe unë! Këto gjobat që kanë vendosur dikur, janë paguar, apo janë parashkruar? Vetëm këtë pyetje kam? Pra jua kanë marrë ato lekë?

**Z. Pal Shkambi jurist, përfaqësues i zonjës Orjeta Shkambi:** Jo, nuk i kanë marrë se nuk kanë pas ku me i marrë. Lekë kot unë nuk jap!

**Z. K. Bele:** Në rregull faleminderit! Ylli, fjala për ju!

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, në Ligjin “Për Partitë Politike” dhe udhëzimin nr. 10 të Komisionerit është parashikuar që brenda datës 31 mars të çdo viti kalendarik, partitë politike që janë të regjistruara në regjistrin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë janë të detyruara të dorëzojnë raportin financiar për vitin kalendarik. Për vitin kalendarik 2021 kanë dorëzuar nga 132 parti politike, që janë të regjistruar në regjistrin e partive politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 46 parti politike. Për auditimin e këtyre raporteve financiare të dorëzuara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, KQZ-

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*


ja ka zgjedhur 20 auditues për të audituar të gjitha raportet financiare të tyre. Nga këto, partitë politike që janë audituar midis të tjerash kanë marrë shumë gjopa nga Komisioneri gjatë shqyrtimit administrativ. Ndër to edhe subjekti politik Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë. Në raportin e audituesit thuhet që “kjo parti nuk ka bashkëpunuar me audituesin”. Ky projektraport i gjetjeve që është përpunuar pasi ka ardhur nga audituesi, nga administrata e KQZ-së, ju është nisur paraprakisht të gjitha partive që kanë pasur gjopa. Por dhe atyre që nuk kishin gjopa, ju është nisur kopje fizike dhe elektronikisht, sipas adresave që kanë deklaruar këto parti. Nga momenti që projektraporti ju është nisur partive politike kemi pritur për të parë reagimin e subjekteve që janë sanksionuar me gjopa administrative. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga kjo parti nuk ka ardhur asnjë reagim për projektraportin e gjetjeve. Në këto kushte Komisioneri, ka marrë në shqyrtim dhe në seancë publike ka miratuar raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara për vitin kalendarik 2021.

**Z. K. Bele:** Të njejtën pyetje Ylli, por jo për këtë parti, e kam në tërësi. Në rastet e mëparshme, në zgjedhjet e mëparshme besoj kemi pasur gjopa dhe në kujtesën time, çfarë ndodh me këto gjopa, janë të mbledhshme? Apo mbeten thjesht kur partia do të krijojë ndonjë gjendje financiare mund të... thjesht për të kuptuar karakterin...

**Z. Y. Merkaç:** Ideja është që partitë që marrin financime nga buxheti i shtetit, që janë më aktive në spektrin politik shqiptar, i paguajnë gjopat, ose ju mbahet nga paradhënia... partitë që nuk kanë, pra e kanë “zero” nuk ke si si t’ua marrësh. Ndoshta duhet ndryshuar Ligji “Për Partitë Politike”, që kjo parti nëse nuk paguan duhet të çregjistrohet nga regjistri dhe s’duhet të marrë pjesë në zgjedhje. Ky është një sugjerim, ju faleminderit!

**Z. K. Bele:** Faleminderit! Kjo mbetet për tu parë! Ka ndonjë pyetje nga kolegët?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 12.02.2024*

**Z. I. Rusmali:** Referenca ligjore që ju keni përdorur për sanksionin, është paragrafi i parë i nenit 23/4?

**Z. Y. Merkaj:** Te neni 23/4 është pika 2. “Shkelja e detyrimit për bashkëpunim me ekspertin kontabël...”

**Z. I. Rusmali:** Ky është sanksioni që propozoni, sipas pikës 2?

**Z. Y. Merkaj:** Po!

**Z. I. Rusmali:** Jo pikës 1?

**Z. K. Bele:** Sepse janë dy lloj sanksionesh 60.000 lekë dhe 100.000 lekë. Në rastin objekt shqyrtimi..., ose më saktë. Sanksionet që unë shoh në këto 94, janë dy tipologji, 60.000 lekë dhe 100.000 lekë, referenca është te 23/4, pra është paragrafi i dytë në të gjitha rastet thoni ju?

**Z. Y. Merkaj:** Jo në të gjitha rastet, në disa raste kur nuk ka bashkëpunuar me audituesin është pika 2, për mosdorëzim është pika 1.

**Z. I. Rusmali:** Subjektet politike kur bëhet auditimi duhet të paguajnë dhe audituesin?

**Z. Y. Merkaj:** Për vitin kalendarik e paguan partia për vitin zgjedhor e paguan KQZ-ja.

**Z. I. Rusmali:** Në këtë rast kush e paguan?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

**Z. Y. Merkaj:** Në këtë rast duhet ta paguante partia.

**Z. I. Rusmali:** E keni paguar ju audituesin për shërbimet e tij?


**Z. Pal Shkambi jurist, përfaqësues i zonjës Orjeta Shkambi:** Nuk na i a kërkuar kush lekët, e para! E dyta, nuk kemi pas as prurje, as dalje.

**Z. I. Rusmali:** Në rregull e mora përgjigjen, të lutem ju dëgjova.

**Z. K. Bele:** Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka! Duke qenë se në të njejtën çështje jemi duke shqyrtuar dhe kërkesën ankimore nr. 3 dhe nr. 4, në seancën paraprahe kemi pasur përfaqësues të subjektit Partia G99 dhe është mbajtur dhe qëndrim nga ana e tij. Gjithashtu për ankuesin tjetër Aleanca Popullore nuk ka pasur prezencë. Gjithsesi për procedurë dy fjalë për këto dy ankime. Seanca vazhdon dhe në mungesë të tyre. Në qoftë se ke diçka për të shtuar.

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, siç relatova dhe më parë që të mos bie në përsëritje, në datën 31 mars, partitë politike duhet të dorëzojnë raportin financiar edhe në qoftë se kanë shpenzimet e vitit kalendarik zero. Është detyrim ligjor që ke, apo nuk ke shpenzime duhet të deklarosh në KQZ dhe kur të vijë audituesi duhet t'i përgjigjesh audituesit për të gjitha pyetjet që ai bën. Në të njejtën mënyrë janë dhe të dyja këto parti. Partia G99 dhe Partia Aleanca Popullore nuk kanë deklaruar të ardhura pasi pretendojnë se kanë niptin pasiv. G99 nuk ka dorëzuar fare sepse thotë që e kam niptin pasiv, ndërsa Aleanca Popullore e ka niptin pasiv por ka deklaruar zero shpenzime.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

**Z. K. Bele:** Pasiv nga pikëpamja fiskale?

**Z. Y. Merkaj:** Po nga pikëpamja fiskale.

**Z. K. Bele:** Janë deklaruar me status pasiv pranë administratës tatimore?

**Z. Y. Merkaj:** Po!

**Z. K. Bele:** Ka raste të tjera përveç këtyre partive dhe a kemi ndonjë qëndrim të mëparshëm mbajtur në lidhje me këtë tipologji? Pra, subjekte të deklaruara pasive nga ana fiskale?

**Z. Y. Merkaj:** Jo, KQZ-ja ka mbajtur qëndrim pavarësisht se e ke niptin pasiv. Përderisa ti ke dalë në treg si parti politike për të shpалosur alternativa të ndryshme nga ato të qeverisjes, duhet të jesh aktiv dhe së pari duhet të dorëzosh raportin financiar vjetor me shpenzimet zero.

**Z. K. Bele:** Koncepti “alternativë” do të thotë të marrësh pjesë në fushatë. Pra, ju thoni që çdo parti e regjistruar në regjistër, nëse e kuptova drejt, që rezulton me status aktiv nga pikëpamja e regjistrimit si subjekt politik në regjistrin përkatës të partive do të duhet të deklarojë shpenzime për çfarëdolloj fushate zgjedhore.

**Z. Y. Merkaj:** Edhe me status pasiv po të jetë duhet të deklarojë shpenzime zero. Ky është qëndrimi i KQZ-së.

**Z. K. Bele:** Në rregull!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

**Z. E. Lako:** Një pyetje kam! Ylli me dy fjalë, si ka qenë mungesa e bashkëpunimit në rastin e Partisë Aleanca Popullore, që është dënuar me gjobë 100.000 lekë sipas nenit 23/4, pika 2? Pra, sipas pikës 2, sanksionohet subjekti politik që nuk bashkëpunon me ekspertin kontabël të KQZ-së, dënohet me gjobë nga 100.000 – 200.000 lekë. Si e provoni ju që nuk kanë bashkëpunuar këta? Meqenëse nuk është dhe pala prezent.

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, në çdo fillim viti kalendarik, KQZ-ja i bën një kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku mbahet regjistri i partive politike. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i jep KQZ-së të gjithë regjistrin e partive politike që janë të regjistruara në atë regjister. Gjithashtu dhe numrat e kontaktit dhe emrat e kryetarëve të partisë. Me të marrë këtë shkresë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ju bën kërkesën partive politike. Në këtë rast, pra në rastin konkret i është bërë kërkesë Partisë Aleanca Popullore, i është përgjigjur kërkesës së KQZ-së, ka dhënë adresën e selisë së partisë, emrin e kryetarit, numrin e telefonit, emrin e financierit. Më pas kur ka shkuar audituesi për të audituar fondet financiare të partisë të vitit 2021, nuk i është përgjigjur dhe nuk i ka kontaktuar.

**Z. E. Lako:** Pra, i është dërguar me shkresë nga ana e ekspertit dhe subjekti politik nuk i ka kthyer përgjigje brenda afatit të caktuar.

**Z. Y. Merkaj:** Po, i jepet numri i kryetarit dhe numri i financierit.

**Z. E. Lako:** Janë të administruara në dosje këto?

**Z. Y. Merkaj:** Po, janë në raportet e audituesit.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

**Z. K. Bele:** Këtu në pikën 5, faqja 16 e raportit, duke ju referuar vendimit të Komisionerit referohet gjetja në raportin ku thuhet “Partia Popullore Kristiandemokrate: Pasi audituesi ka kontaktuar me partinë politike, nuk është dhënë asnjë dokumentacion tjetër vërtetues mbi bazën e të cilit janë përgatitur pasqyrat financiare”. Pra, në kuptim të drejtë nuk i është dhënë asnjë dokumentacion tjetër vërtetues, dmth, atij do t’i jetë dhënë ndonjë dokumentacion, ose kështu e kuptoj unë. E dyta, gjithashtu thotë që “partia ka informuar se nuk është regjistruar në organet tatimore si detyrim i kërkuar”. Pra, partia e paska informuar dhe mesa duket i ka dhënë një letër dhe jo dokumentacion tjetër. Pra, këtu kuptohet që ka pas kontakt...

**Z. Y. Merkaj:** Fillimisht ka pas komunikim, pastaj nuk i është përgjigjur më.


**Z. K. Bele:** Pastaj si?

**Z. Y. Merkaj:** Një nga detyrat e audituesit është që të verifikojë dhe të shohë...

**Z. K. Bele:** Pra, audituesi e ka konstatuar faktin dhe e pranon në gjetjen e tij. Ai relatton që “subjekti e ka informuar që nuk është i regjistruar në organet e tatimeve”. Nuk kemi ndonjë konfirmim, apo pohim nga audituesi që ky fakt është apo jo i pavërtetë. Unë nuk e kuptoj pse shkohet te mungesa e bashkëpunimit në këtë rast. Nëse audituesit i kanë thënë që kjo nuk është e regjistruar dhe ai e ka pranuar këtë gjetje, për sa kohë nuk e ka kundërshtuar. Kjo do të thotë që nuk ka mungesë bashkëpunimi, ose unë vendos një pikëpyetje. Ku dallon ky rast nga rastet e tjera?

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, në rastin... prandaj vendoset audituesi. Në rast se një parti politike i deklaron shpenzimet zero, audituesi ka një nga detyrat e tij që të investigojë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

dhe të kërkojë dokumenta shtesë partisë. Në këtë rast ata nuk i kanë dërguar dokumentat shtesë që i janë kërkuar nga eksperti dhe kjo është konsideruar, mosbashkëpunim me ekspertin, nga KQZ-ja. Nuk është shprehur nga eksperti që shpenzimet janë zero, apo ka dhe shpenzime të tjera të bëra.

**Z. L. Braho:** Të të bëj një pyetje unë, kur këta e vetëdeklarojnë që është zero, çfarë dokumenti mund të kesh që të vërtetosh zeron?

**Z. Y. Merkaj:** Ne pretendojmë që mundet të ketë shpenzuar partia politike.

**Z. L. Braho:** Po kjo nuk vërtetohet me letra, kjo vërtetohet nga gjendja faktike gjatë fushatës.


**Z. Y. Merkaj:** Fjala është për gjatë vitit.

**Z. L. Braho:** Po pra, gjatë vitit. Në qoftë se ky thotë që është zero, dmth nuk ka kryer asnjë aktivitet. Çfarë letrash kërkon për të vërtetuar që nuk ka kryer asnjë aktivitet?

**Z. Y. Merkaj:** Ligji “Për Partitë Politike” thotë “pavarësisht se se e deklaron partia politike, përsëri kjo parti duhet të auditohet”. Të auditojë financat dhe aktivitetin e partisë.

**Z. I. Rusmali:** Mirë, ta shohim nga ky këndvështrim. Cilat janë dokumentat që ka kërkuar audituesi nga subjekti? Ju thatë që janë kërkuar dokumenta dhe nuk janë marrë dokumenta. Ky proces i kërkimit të dokumentave, mund të na bëhet transparent ne për rastin konkret?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

**Z. Y. Merkaj:** Po citoj pjesë nga raporti i audituesit i cili thotë “pavarësisht kontaktit të siguruar me subjektin politik dhe pasqyrave financiare të përgatitura për vitin 2021 të vëna në dispozicion, rezulton se subjekti politik nuk ka kryer asnjë aktivitet, nuk ka përfutuar fonde dhe kryer shpenzime përgjatë vitit 2021 dhe përgjatë vitit të mëparshëm 2020. Asnjë dokument tjetër vërtetues përkatës mbi bazën e të cilit janë përgatitur këto pasqyra. Nuk ka dokument që ta vërtetojë që këto pasqyra janë zero, si dhe informacione të tjera që të mundësojnë auditimin tonë sipas kërkesave të ligjit...”.

**Z. I. Rusmali:** Ku e ka selinë subjekti?

**Z. Y. Merkaj:** Në Shkodër!

**Z. Pal Shkambi jurist, përfaqësues i zonjës Orjeta Shkambi:** Mund të flas unë?

**Z. I. Rusmali:** Çfarë adrese? Është shtëpia juaj, apo godinë?


**Z. Pal Shkambi jurist, përfaqësues i zonjës Orjeta Shkambi:** Është godinë te zona industriale, lagjja Skënderbeu.

**Z. I. Rusmali:** Si e administroni godinën?

**Z. Pal Shkambi jurist, përfaqësues i zonjës Orjeta Shkambi:** Ajo godinë është godinë e imja. As kam marrë, as kam dhënë, thjesht e kam lënë për partinë.

**Z. I. Rusmali:** Keni dëgjuar për donacionet në natyrë ju?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

**Z. Pal Shkambi jurist, përfaqësues i zonjës Orjeta Shkambi:** Kemi dëgjuar, por nuk bëhet fjalë se nuk ka asgjë partia vetë, veç statutit dhe programit.

**Z. I. Rusmali:** E ka verifikuar eksperti selinë e partisë?

**Z. Y. Merkaç:** Ka kontaktuar dhe një nga kërkesat që i ka bërë nënkryetares së partisë ka qenë, “pavarësisht se godina është në emrin e një prej anëtarëve të partisë, por të paktën në këtë godinë sikur një llampë të ndizet, duhet të ketë një librezë energjie elektrike”...


**Z. I. Rusmali:** Siç e mbaj mend unë në zgjedhje, këto pasuritë që vihen në dispozicion konsiderohen donacione në natyrë dhe kalkulohen me një vlerë të caktuar. Kjo është edhe për raportimin gjithëvjetor.

**Z. Y. Merkaç:** Po edhe donacionet në natyrë, në qoftë se ka dhurime gjatë vitit kalendarik, duhet të deklarohen.

**Z. I. Rusmali:** Në rregull!

**Z. K. Bele:** Edhe një pyetje kam unë Ylli! Shoh këtu në materialin e përmbledhur që 80 parti politike nuk janë audituar për shkak të adresave jo të sakta. Këto janë 80 partitë që kanë marrë gjobën 60.000 lekë, apo jo? Këto që nuk kanë adresë. Këto 13 të tjerat ku një rast thuhet që ka pas bashkëpunim dhe citohet një koorespondencë. Këto janë subjektet që kanë marrë gjobën 100.000 lekë, apo jo? Pra, kush është gjetur dhe është përgjigjur ka marrë 100.000 lekë? Kush nuk është përgjigjur ka marrë 60.000 lekë, e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

kuptuam. Duke qenë se nuk ka pyetje nga kolegët, në këtë fazë përfundimisht zoti Shkambi, çfarë kërkonte nga KAS?


**Z. Pal Shkambi jurist, përfaqësues i zonjës Orjeta Shkambi:** Faleminderit! Në rradhë të parë në lidhje me këto gjobat që vendos KQZ-ja, pavarësisht se për fatin e mirë jeni ju hallka tjetër dhe gjykata..., apo kanë kohë për të humbur njerëzit... Kjo është një filozofi për të vrarë pluralizmin. Si për fundim, në këto rrethana, në zbatim të nenit 23/4, pika 2 të ligjit “Për Partitë Politike” i përditësuar, i kërkojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, shfuqizimin e pikës 96, të vendimit nr. 823, datë 7.12.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike, për vitin kalendarik 2021”, për heqjen e masës administrative për partinë politike Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, me gjobën me vlerë 100.000 lekë. Kjo është kërkesa jonë për KAS-in, faleminderit!

**Z. K. Bele:** Faleminderit! Ylli, fjala për ju, përfundimisht!

**Z. Y. Merkaj:** Lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 823, datë 7.12.2023.

**Z. K. Bele:** Faleminderit! KAS i konsultuar në vend vendos të tërhiqet për të marrë vendim. Caktojmë si orar për shpalljen e vendimit, nëse nuk do të kemi ndonjë vonesë, pas 20 minutash në orën 13:15. Në rast se do të kemi vonesë do t’ju njoftojmë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 12.02.2024*

**Rifillon seanca**

**Ora 13:27**

Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 1. KAS në përfundim të shqyrtimit vendosi:

- pranimin e pjesëshëm të ankimit të Partisë Popullore Kristiandemokrate të Shqipërisë dhe të Partisë Aleanca Popullore;
- ndryshimin e pikës 96 dhe 101 të vendimit nr. 823, datë 7.12.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- vendosjen e sanksionit administrativ gjobë, në vlerën 60.000 lekë sipas nenit 23/4, pika 1 të ligjit “Për Partitë Politike”;
- rrëzimin e kërkesës nr. 03 subjektit politik Partia G99;
- ky vendim shpallet sot me datë 12.02.2024;
- kundër këtij vendimi bëhet ankim në Gjykatën Administrative brenda një afati 45 ditë.

Me kaq seanca deklarohet e mbyllur!

**Vendimi nr. 08**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

